

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 E martë, 27 qershor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.29

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjes dhe mirë se erdhët.

7 Znj. Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i
10 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Të shohim kush është i pranishëm sot në sallën e gjyqit?

14 ZPS-ja.

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Për ZPS-në sot, të pranishëm
16 janë Line Pedersen, menaxheren e çështjes; Filippo de Minicis,
17 Prokuror edhe unë, Gaia Pergolo, Prokurore e Asociuar.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Mbrojtësi i Viktimave, e keni fjalën ju.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Unë
21 jam Simon Laws, Mbrojtësi i Viktimave, së bashku me
22 bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Mbrojtja e të akuzuarit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 2

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjes. Jemi thujse të
2 njëjtët persona që ishim dhe dje. Unë jam Jean-Louis Gilissen.
3 Z. Hedi Aouini, znj. Cariolou dhe kemi gjithashtu edhe znj.
4 Petravica, menaxhere e çështjes. Kemi gjithashtu të pranishëm
5 përmes videolidhjes z. Shala. Faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
7 Shala, mirëmëngjes, a më konfirmon që më dëgjoni mirë?

8 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Ju ndëgjoj
9 shumë mirë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] [Nuk
11 ka përkthim].

12 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] E nderuara Gjyqtare,
13 nuk ka përkthim. Nuk kuptoj gjë, asnjë fjalë çka keni thënë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
15 dëgjoni z. Shala?

16 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
17 këshillohen]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 Shala, më dëgjoni? Më dëgjoni tani?

20 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, po.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo
22 çfarë do të bëjë, z. Shala, është që do të filloj dhe një herë
23 tjetër nga fillimi, pra, do të filloj me urdhrat me gojë nga
24 fillimi fare në mënyrë që të sigurohem që ju po ndiqni. Në
25 rregull?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 3

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Ju faleminderit shumë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Atëherë, urdhri i parë me gojë ka të bëjë me kërkesën e
4 Mbrojtjes për të shtyrë mbylljen e paraqitjes së provave të
5 ZPS-së që është planifikuar që të ndodhë më 6 korrik 2023.

6 Më konkretisht, dje gjatë seancës së djeshme, në
7 transkript të seancës më datë 26 qershor 2023, faqe 12,
8 rreshtat 24 deri në faqen 14, rreshti 10, Mbrojtja bëri një
9 kërkesë për Trupin Gjykyues për të shtyrë mbylljen e paraqitjes
10 së provave nga ZPS-ja derisa ky Trup Gjykyues të marrë një
11 vendim për kërkesën e ardhshme të Mbrojtjes për leje për
12 apelim të vendimit të kërkesave të Prokurorit të Specializuar
13 për të pranuar dëshmitë e 402 dhe 404 sipas rregullës 153 të
14 Rregullores - që është parashtrimi i protokolluar 00556 - dhe
15 eventualisht edhe vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit për këtë
16 çështje.

17 Pasi ka dëgjuar parashtrimet e palëve, Trupin Gjykyues nuk
18 shikon asnjë arsye për të shtyrë mbylljen e paraqitjes së
19 provave nga ZPS-ja dhe konstaton se kjo nuk është në interes
20 të zhvillimit eficient të procedurave. Kjo nuk cenon
21 vendimmarrjen e Trupit Gjykyues për kërkesën e ardhshme për
22 leje për apelim, në qoftë se kjo do të miratohet edhe, në
23 qoftë se Gjykata e Apelit do tjetërsoj vendimin atëherë do të
24 vendosim sesi do vijojmë më tej.

25 Kështu që, për rrjedhojë kërkesa e Mbrojtjes

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 4

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 kundërshtohet.

2 Kjo përfundon urdhrin e parë me goje të Trupit Gjykses.

3 Tani do të vazhdoj me një urdhër të dytë gojor.

4 Gjatë seancës së ditës së djeshme, i referohem
5 transkriptit të seancës së datës 26 qershor 2023, faqja 3,
6 rreshti 24, deri në faqen 7, rreshti 16 dhe faqja 27, rreshtat
7 11 deri në 20, Mbrojtja bëri kërkesë për Trupin Gjykses që të
8 shtyjë kundërpyetjen e Dëshmitarit 04826, që fillimisht ishte
9 planifikuar për 40 orë dhe që të shtyhej, pra, për një javë
10 seanca, në mënyrë të tillë që të kishte kohë të mjaftueshme
11 për t'u konsultuar me ekspertin e tyre dhe për të përgatitur
12 pyetje për dëshmitarin.

13 Gjatë së njëjtës seancë, ZPS-ja tha kundërshtimin e vet
14 lidhur me kërkesën e Mbrojtjes. Kjo i referohet transkriptit
15 të seancës së djeshme, faqe 28, rreshtat 2 deri në 10.

16 Pasi ka marrë parasysh parashtrimet e palëve dhe duke
17 marrë parasysh faktin që salla e gjyqit nuk është e
18 disponueshme të enjten dhe të premtën, Trupi Gjykses vendos që
19 të shtyjë kundërpyetjen e Dëshmitarit 04826 deri javën që
20 vjen. Ne kemi marrë konfirmim se kemi përkthyes të
21 disponueshëm për datën 3 korrik dhe kjo do të thotë që do
22 vazhdojmë me marrjen në pyetje të dëshmitarit nga Mbrojtja të
23 hënën.

24 Gjithashtu, për të siguruar kryerjen efikase dhe të
25 shpejtë të procesit gjyqësor, Trupi Gjykses i bën thirrje

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 5

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 Mbrojtjes që të sigurohet që të jetë në një pozitë të tillë që
2 të ketë të disponueshëm ekspertët e vetë gjatë gjithë javës që
3 vjen dhe të ketë të disponueshëm ekspertët për dy dëshmitarët
4 ekspertë.

5 Ky është fundi i urdhrit të dytë gojor.

6 Tani do të vazhdojmë me marrjen në pyetje të z. Gasior.

7 Z. Avokat i Mbrojtjes, e keni fjalën ju.

8 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

9 Dua t'ju jap pak informacion sa i takon konsultimit me
10 ekspertin. Kolegia ime, znj. Cariolou e tha dhe dje, që një
11 prej dy ekspertëve që ne kemi të disponueshëm, nuk ishte e
12 disponueshme dje dhe sot. Megjithatë, jemi koordinuar me
13 koordinuesen e institucionit sot dhe jemi në procesin e
14 sigurimit të pyetjeve të duhura dhe atyre pjesëve të
15 informacionit për të cilët kemi nevojë për këshillimin e
16 ekspertit. Duhet të jemi në gjendje që ta transmetojmë këtë
17 informacion në mënyrë të sigurtë sot edhe besojmë që deri në
18 fund të javës eksperti ynë do të ketë mundësi që të na japë
19 përgjigje për pyetjet që kemi.

20 Kështu që jemi të qëndrimit që jemi të gatshëm që të
21 vazhdojmë me marrjen në pyetje të dëshmitarit nga ana jonë të
22 hënën.

23 Faleminderit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Avokat, ditën e kemi përcaktuar tashmë për marrjen në pyetje

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 6

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 të dëshmitarit prej jush, pra, data është të hënën.

2 Faleminderit, për informacionin e dhënë.

3 Znj. Prokurore, e keni ju fjalën.

4 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Duam të bëjmë një korigjim për
5 transkriptin e djeshëm. Nuk e di në qoftë se është momenti i
6 përshtatshëm këtu për të bërë korigjimin apo jo. Por është në
7 faqen e fundit të transkriptit të përkohshëm të djeshëm, në
8 faqen 73, rreshti 20, pra, në transkript thuhet që: "Kemi
9 përdorur besoj deri një orë dhe 15 minuta", por ndërkohë e
10 kisha fjalën për një orë e 50 minuta, jo 15 minuta. Dhe ky
11 është korigjimi që dua të bëj në transkriptin provizor të
12 djeshëm.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit, znj. Prokurore. Atëhere në vend të një orë e 15
15 minuta kemi një orë e 50 minuta. Korigjimi u mor parasysh.

16 Pra, ne do të mundohemi që të mos shkojmë përtej orës
17 4.00 pasdite, në qoftë se nuk ka ndonjë arsye të fortë. Pra,
18 do ta zgjasim vetëm në qoftë se do jetë absolutisht e
19 nevojshme, nuk është se bën ndonjë ndryshim për neve,
20 megjithatë, është e rëndësishme për neve që na e bëtë këtë
21 sqarim sepse e kemi më të qartë sa i takon orës apo orarit që
22 kemi në dispozicion sot.

23 Në qoftë se nuk ka ndonjë pyetje Mbrojtësi i Viktimave,
24 që duket se nuk ka, do t'i kërkoja Sekretares që të sjellë
25 dëshmitarin në sallë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 7

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 [Dëshmitari vijon dëshminë]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Mirëmëngjes dhe mirë se erdhët.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] *Good morning*. [Në anglisht]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

6 lutem, uluni.

7 Z. Gasior, më dëgjoni mirë?

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, ju dëgjoj mirë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si
10 jeni sot?

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Shumë mirë. Faleminderit, e
12 nderuar Gjykatëse. Nuk jam aq i stresuar sa isha dje, më duhet
13 ta them këtë gjë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull. Kënaqësi që e dëgjojmë.

16 Z. Shala, na dëgjoni? E dëgjoni dëshmitarin?

17 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e ndëgjoj shumë
18 mirë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit, z. Shala.

21 Sot do të vazhdojmë me marrjen në pyetje nga Zyra e
22 Prokurorit të Specializuar.

23 Z. Gasior, ju kujtoj që jeni akoma nën betim.

24 Tani dua t'ia jap fjalën znj. Prokurore për të vazhduar
25 me pyetjet.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 8

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 Znj. Prokurore, fjala për juve.

2 DËSHMITARI: MAREK GASIOR [Vijon]

3 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

4 Pyetje nga Znj. Pergolo: [Vazhdim]

5 PY. Mirëmëngjes, Dr. Gasior.

6 PË. Mirëmëngjes.

7 PY. Do ta fillojmë ditën e sotme aty ku e lamë dje, po

8 flisnim konkretisht për trajektoren e tri goditjeve me armë

9 mbështetur në lëndimet që u gjetën në trup.

10 Tani dëshiroj t'ju tregoj projektoren që vlerësuat në një
11 prej fotografive të cilat janë pjesë e raportit.

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Me lejen tuaj, të nderuar
13 Gjykatës, dua që të paraqitet në ekran raporti dhe një faqe e
14 veçantë e këtij raporti. Jam e gatshme t'ju jap edhe numrin
15 ERN.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Vazhdoni, znj. Sekretare.

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Është dokumenti me numër 031049
19 deri në 031095 RED2. Dhe dëshiroj që të shfaqet në ekran
20 dokumenti me numër ERN që përfundon me -66. Ju lutem, zmadhoni
21 fotografinë 36.

22 PY. Dr. Gasior, a e shikoni fotografinë 36, e keni përpara?

23 PË. Po, kam përpara fotografinë me numrin 36, kështu që mund
24 ta shikoj.

25 PY. Së pari, a mund të na shpjegoni se nga cili kënd i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 9

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 shikoni kockat këtu, domethënë, nga cili kënd i trupit në

2 raport me trupin, mund të na e shpjegosh pak?

3 PË. Në fotografinë 36, kjo është pjesa laterale, domethënë,

4 është pamja laterale e gjurit të djathtë.

5 PY. Në qoftë se mund të na e tregoni te skeleti që keni

6 përpara, thjesht për ta kuptuar më mirë, nga cila pamje është

7 marrë, domethënë, kjo fotografia që kemi këtu përpara në

8 ekran?

9 PË. Kjo është kupa e gjurit e poshtme, është tibia e këmbës

10 dhe fibula.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për

12 procesverbal deklaroj që dëshmitari sapo na ilustroi katër

13 kockat e ndryshme të cilat ai i tha me zë.

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e

16 dëgjova përkthimin në anglisht. Dëgjuam që eksperti thoshte

17 diçka në gjuhën e vet. Po nuk e dëgjuam përkthimin në

18 anglisht.

19 Ju lutem, a mund ta përsërisni edhe një herë pyetjen dhe

20 dëshmitari të flasë dhe besoj që do ta marrim përkthimin.

21 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Unë e kam përgjigjen e

22 dëshmitarit në rreshtin 15, faqen 8, domethënë, ju thatë:

23 "Femuri i poshtëm, kupa e gjurit, tibia, patela".

24 Nuk e di në qoftë se kishte ndonjë tjetër që nuk u

25 përkthye, në qoftë se kishte ndonjë gjë që thatë, mund ta

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 10

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 shtoni, Dëshmitar, në mënyrë të tillë që të përkthehet?

2 PË. Në fotografi, ne mund të shohim kupën e gjurit, diskun,
3 mund të shikojmë gjithashtu edhe fibulën. Pra, mund të shohim
4 katër kocka të cilat së bashku krijojnë këtë pjesën e kockës
5 së gjurit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka
7 një problem me transkriptin, sepse tani e dëgjuam se çfarë tha
8 dëshmitari, po ndërkohë nuk e kemi të pasqyruar në transkript.

9 Z. Dëshmitar, kemi një problem me transkriptin,
10 domethënë, ajo çfarë po thoni juve nuk po paraqitet në
11 transkript, kështu që thjesht po mundohemi që ta zgjidhim këtë
12 si problem.

13 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Gjykatës
14 këshillohen]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
16 rregull. Pati një ngrirje ekrani, pra, transkripti, megjithatë
17 tani është në rregull, kështu që besoj që mund të vazhdojmë më
18 tej.

19 Znj. Prokurore, e keni përsëri ju fjalën.

20 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

21 PY. Dr. Gasior, duke iu kthyer dhe një herë fotografisë 36,
22 cila prej goditjeve, qëllimeve me armë përfaqësohet nga kjo
23 shigjeta me të kuqe? A mund ta shikoni këtë në ekran në
24 fotografi?

25 PË. Pra, kjo është gjuajtje me armë zjarri të cilën ne e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 11

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 diskutuam dhe dje, pra, është gjuajtje me armë që e diskutuam
2 dje, që është bërë në pjesën e poshtme të femurit të djathtë.
3 Pra, plumbi ka hyrë nga përpara dhe e kemi daljen në pjesën e
4 pasme, në kondil në pjesën e pasme.

5 PY. Përsëri duke parë fotografinë 36, a mund të na thoni se
6 cila është e shtëna me armë e cila përfaqësohet nga shigjeta
7 me ngjyrë blu të lehtë, si bojë qielli?

8 PË. Është gjuajtje me armë, trajektorja është nga poshtë lart
9 dhe nga pjesa mediale tek ajo laterale, tek e jashtme,
10 domethënë, me fjalë të tjera, shkon në drejtimin nga lart.

11 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] A mund të shkojmë në raport, te
12 raporti tek faqja 03051, për të konfirmuar atë që sapo na
13 tregoi dëshmitari.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
15 lutem vazhdoni.

16 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

17 PY. Dr. Gasior, në qoftë se do të shikojmë tre pikat e
18 plumbave nuk e di në qoftë se do të mund të na thoni se cila,
19 domethënë, a mund të na thoni se cila përkon me këtë plumbin
20 që sapo na shpjeguat tani, cila prej këtyre ka të bëjë me
21 plumbin e shpjeguar tani, me trajektoren e shpjeguar prej
22 jush, pra, është nën këtë pjesën "Lëndimet që janë në
23 përputhej me tre të shtënat me armë nga mbrapa"?

24 PË. Është pika e dytë këtu, sepse këtu thotë "nga poshtë
25 lart" dhe "nga pjesa e përparme në pjesën e pasme". Pak a

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 12

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 shumë ky është shpjegimi që jepet këtu.

2 PY. Në qoftë se do të kalojmë tek plumbi i tretë, lexoj që

3 është:

4 "E shtëna e tretë nga pjesa e përparme në pjesën e pasme

5 dhe nga poshtë lart dhe pak në pjesën mediale deri në atë

6 laterale".

7 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] A mund të shohim një fotografi

8 tjetër. Dëshiroj që të na transmetohet fotografia 36,

9 domethënë, është në dokumentin 031066, fotografia 36.

10 PY. Dr. Gasior, a e kuptoj drejt se e shtëna e tretë që u

11 përshkrua në raport është ajo pika, që ju sapo na lexuat,

12 përfaqëson këtë shigjetën me ngjyrë të gjelbër në këtë

13 fotografi, kështu është?

14 PË. E shtëna e tretë, po, është e vërtetë është e shënjuar me

15 këtë shigjetën me ngjyrë si jeshile.

16 PY. Faleminderit. Sa për të bërë një lloj sqarimi ndoshta me

17 fjalë mjekësore. A mund të na shpjegoni ju lutem se çfarë do

18 të thotë pjesa e mesme, pjesa mediale? Mund të na e shpjegosh

19 me fjalë të tilla që të mund ta kuptojmë ne?

20 PË. Pjesa mediale, do të thotë në drejtim të mesit të trupit.

21 Në aspektin anatomik, të gjitha lëndimet, sikurse e thashë,

22 janë përshkruar duke marrë parasysh që trupi është në

23 pozicionin anatomik, pra, është i shtrirë në dysHEME, i ka

24 fytyrën, domethënë, duart i ka duke qenë në pjesën nga sipër.

25 Dhe në mes fare ne kemi atë çfarë quhet linja ose vija e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 13

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 mesit dhe të gjitha konstatimet janë bërë duke marrë parasysh
2 këtë vijën e mesit, domethënë, të gjitha lëndimet janë
3 përcaktuar duke marrë si pikë reference këtë vijë të mesit.

4 Dhe në këtë rast pjesa e kockës është kjo pjesa mediale ose e
5 mesme. Ndërkohë që pjesa tjetër, pjesa e pasme është ajo
6 laterale.

7 PY. A do ishte e saktë që të thuhej, mbështetur në shpjegim
8 që sapo na dhatë, që është shtënë me armë zjarri nga pjesa
9 mediale në atë laterale është një e shtënë, domethënë, është
10 armë zjarri ose plumb që përshkon trupin nga pjesa e brendshme
11 në drejtim të pjesës së jashtme. A mund ta përshkruaj kështu?

12 PË. Po. Mund të përshkruhet edhe kështu.

13 PY. Faleminderit, Dr. Gasior.

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Tani a mund të kërkoj që të
15 paraqitet në ekran një tjetër faqe e të njëjtit raport, e kam
16 fjalën për dokumentin me numër ERN 03105.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
18 lutem, vazhdoni.

19 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] A mund ta zvogëlojmë pak për të
20 parë të gjithë trupin. Po, shumë mirë.

21 PY. Z. Gasior, a mund të konfirmoni që ky imazh përfaqëson
22 trajektoren e plumbave që sapo na shpjeguat dhe që keni
23 diskutuar sot më herët por edhe gjatë ditës së djeshme?

24 PË. Tek imazhi në të majtë kemi pjesën e brendshme, pra, me
25 fjalë të tjera, shikojmë fibulën e mesme deri në pjesën

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 14

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 laterale ose anësore. Ose të paktën. Domethënë, kjo është
2 mënyra sesi shkon cila është trajektorja e shigjetës këtu.
3 PY. Shumë faleminderit.

4 Dr. Gasior, më herët sot na shpjeguat, por na e shpjeguat
5 edhe dje këtë gjë, që të gjitha lëndimet e gjetura në skeletin
6 e këqyrur prej jush janë dhënë duke marrë parasysh pozicionin
7 anatomik të trupit, pra, me fjalë të tjera, trupi është i
8 vendosur në mënyrë të drejtë, sikurse na e shpjeguat dhe dje.
9 Dhe sa për procesverbal, dua që t'i referohem transkriptit të
10 ditës së djeshme në faqen 69, rreshtat 10 deri në 15, e keni
11 dhënë këtë shpjegim.

12 Me sa kuptoj unë kjo është mënyra standarde për të
13 përshkruar konstatimet në një raport autopsie. A është e saktë
14 kjo?

15 PË. Kjo është mënyra standarde, kjo është mënyra që është e
16 pranueshme në mjekësinë ligjore dhe kur përshkruhet
17 vendndodhja e lëndimeve të trupit të personit të vdekur, kjo
18 është mënyra standarde që bëhet raportimi për ato që
19 konstatohen në trupin e viktimës.

20 PY. Faleminderit. Z. Gasior, mbështetur në konstatimet në
21 aktekspertizën e autopsisë, a ishte e mundur për ju për të
22 arritur në përfundimin se në çfarë pozicioni ka qenë pacienti
23 ose individi A në kohën kur është shtënë në drejtim të tij?

24 PË. E keni fjalën për lëndimet, për plagët, ato të cilët kanë
25 qenë të pranishëm apo të dukshëm në trup përshkruhen në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 15

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 përputhje me pozicionin anatomik të qenies njerëzore. Tani, sa
2 i takon pozicionit aktual sesi ka qenë, në çfarë pozicioni ka
3 qenë individi A kur është shtënë në drejtim të tij, më vjen
4 keq po nuk jua them dot këtë gjë.

5 PY. Konstatimet tuaja a do të ishin në përputhje me supozimin
6 që individi A ka qenë i ulur në momentin kur është gjuajtur me
7 armë?

8 PË. Unë e kisha fjalën për trajektoren e plumbit dhe të
9 plagëve që u shkaktuan nga plumbi. Megjithatë, se cili ka qenë
10 pozicioni në të cilin ndodhej personi kur ky person është
11 gjuajtur me armë zjarri, kjo shkon përtej mjekësisë ligjore,
12 del jashtë mjekësisë ligjore. Dhe përgjigja nuk varet vetëm
13 nga pozicioni që ka pasur personi por edhe nga drejtimi, pra,
14 prej nga është qëlluar.

15 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

16 PY. Faleminderit, Dr. Gasior. Kam edhe një pyetje të fundit
17 lidhur me këtë akt autopsie. Dje i diskutuam, folëm për
18 konstatimet tuaja sa i takon shkakut të vdekjes në faqen 68 të
19 transkriptit rreshtat 4 dhe 5 më saktë, ju na folët për një
20 arterie e cila furnizon me gjak të gjithë gjymtyrën. Në të
21 njëjtën faqe të transkriptit në rreshtat 15, 16, ju keni
22 deklaruar dhe po ju citoj:

23 "Plaga e plumbit me shkatërrim total të arteries shkakton
24 hemorragji".

25 Sipas mendimit tuaj si mjek, çfarë do të ndodhte nëse një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 16

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 plagë e tillë lihet e patrajtuar?

2 PË. Lëndimet, pra, një plagë e cila shkaktohet me plumb me
3 armë zjarri, nëse nuk trajtohet shpejt dhe menjëherë, sjell
4 për pasojë vdekjen si rezultat i hemorragjisë, pra,
5 gjakrrjedhjes apo i ndërlikimeve të tjera të cilat vijnë nga
6 plaga e shkaktuar.

7 PY. Faleminderit, Dr. Gasior. E kemi përfunduar këtë pjesë
8 për këtë akt autopsie, dëshiroj tani të kaloj tani në një
9 tjetër dokument.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Dokumenti mund të hiqet nga ekrani, znj. Sekretare.

13 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani
14 dëshiroj që të paraqitet në ekran një dokument tjetër me numër
15 ERN SITF00019134.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
17 çfarë do të flasim tani?

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Do të flasim për një dokument
19 tjetër, së pari dëshiroj që dëshmitari të identifikojë
20 dokumentin. Do të ndjek të njëjtën procedurë si me
21 atkautopsinë, fillimisht do t'i kërkoj dëshmitarit që të
22 identifikojë dhe të vërtetojë origjinalitetin e aktit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
24 rregull.

25 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit. Dhe për ta

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë private)

Faqe 17

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 plotësuar numrin, sekuenca është deri në 19147 RED2.

2 Të nderuar Gjykatës, sa për sqarim, ka një version tjetër
3 të të njëjtit dokument për të cilin kemi kërkuar për të cilin
4 kemi kërkuar që të përfshihet në materiale. Në fakt, ka disa
5 mospërputhje midis këtyre dy versioneve kështu që unë me lejen
6 tuaj kërkoj që të përdorë të dy dokumentet, por do filloj me
7 këtë version fillimisht.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
9 mundet. Nuk kemi marrë vendim në formë shprehimisht sepse
10 është i njëjti dokument. Por për shkak të papërputhshmërive ne
11 do të lejojmë dhe përdorimin.

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

13 T'i tregojmë dëshmitarit faqen që mbaron me numrat 136 të
14 këtij dokumenti.

15 Të nderuar Gjykatës, nëse mundet të kalojmë në seancë
16 private për të folur për disa informacione të mbrojtura.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
18 rregull.

19 Znj. Sekretare, ju lutem të kalojnë në seancë private.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë private)

Faqe 18

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21 [Seancë e hapur]

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

23 jemi në seancë publike.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 19

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 Znj. Prokurore, keni fjalën.

2 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

3 PY. Dr. Gasior, e keni përgatitur ju këtë raport?

4 PË. Këtë raport, vërtetë, e kam përpiluar unë pasi e kreu

5 këqyrjen e pacientit, pra, të individit B. Ky raport ka numrin

6 [REDAKTUAR]

7 PY. Faleminderit. Të kalojmë tani tek faqja me numër 138,

8 nëse është e mundshme.

9 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë tek pjesa e
10 poshtme e faqes.

11 PY. E njihni nënshkrimin në këtë faqe?

12 PË. Po, e njoh.

13 PY. I kujt është ky nënshkrim?

14 PË. Është i imi.

15 PY. Dr. Gasior, e keni kryer ju vetë këqyrjen që përshkruhet
16 në këtë dokument?

17 PË. Këtë këqyrje të këtij pacienti e kam kryer unë vetë.

18 PY. Faleminderit. Si u zhvillua procesi i këqyrjes? Ju lutem
19 të na e shpjegoni shkurtimisht sesi ka ndodhur.

20 PË. Pacientin, ose kufomën, e sollën në departamentin e

21 mjekësisë ligjore, siç e them edhe këtu në dokument, dy

22 punonjës policie të cilët ceken këtu në raport në faqen e dytë

23 të tij. Ishin policë, këta policë ndodheshin tek pika e

24 këqyrjes por nuk kishin të pranishëm gjatë këqyrjes së

25 pacientit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 20

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 Tani që e shoh këtë dokument, mund të them se i pranishëm
2 ka qenë dhe fotografi, fotografi kriminalistik i cili ka bërë
3 fotografitë. Persona të tjerë kanë qenë të pranishëm kanë qenë
4 dy infermierë që kanë shërbyer si përkthyes. Informacioni i
5 siguruar është regjistruar në procesverbal.

6 PY. Faleminderit. Dhe pikërisht tani dëshirojmë që të kalojmë
7 tek kjo pjesë tek informacioni, pra, që keni marrë.

8 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë tek faqja e
9 dytë e raportit e këtij dokumenti. Për t'i kërkuar dëshmitarit
10 që të konfirmojë se ky qenë informacioni që ka marrë për
11 individin B.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
13 rregull. Po kam një pyetje, znj. Prokurore.

14 Z. Shala, ju lutem të konfirmoni që të gjitha po i
15 dëgjoni në rregull?

16 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e nderuar.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
18 mirë. Faleminderit.

19 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit. Kalojmë tani tek
20 faqja që mbaron me numrin 137. Diçka më poshtë.

21 PY. Dr. Gasior, shoh se individi B ju ka thënë dhe po ju
22 lexoj nga fjalia e pestë aty ku thotë që është me titullin
23 "Informacioni i marrë nga pacienti":

24 "Më kanë keqtrajtuar dhe me kanë rrahur me shkopinj druri
25 dhe metalik. Më kanë rrahur në kokë e në trup".

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 21

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 Nuk po kaloj te pjesa e fundit se mund të jetë
2 informacion identifikues, po dua vetëm të ndaloj këtu për të
3 parë nëse dëshmitari e ka përpara.

4 Ju kujtohet që jua kanë dhënë këtë informacion?

5 PË. Nga dokumenti që kam përpara se këqyrja është bërë para
6 [REDAKTUAR], nuk më kujtohen tani të gjitha procesverbalet
7 apo aktet që unë i kam përpiluar vetë. Megjithatë, sa i takon
8 këtij procesverbali mund t'ju them se ka ndodhur këqyrja por
9 nuk më kujtohen hollësitë. Druaj se do më duhet që ta shikoj
10 se çfarë shkruhet në këtë dokument. Se është kryer këqyrja
11 para [REDAKTUAR].

12 PY. Ju kuptoj, Dr. Gasior. Faleminderit. Dhe, sigurisht, që
13 raportin këtu e kemi kështu që do t'i përmendim disa prej
14 konstatimeve.

15 Dua që t'ju sjell në vëmendje disa prej këtyre
16 konstatimeve. Janë dua të shohim faqen përkatëse për të
17 shtjelluar këtë.

18 Kështu që ju lutem, Dr. Gasior, të shihni pjesën e
19 poshtme të faqes. Këtu shohim përmendjen e një vraje, pra,
20 shenje plage, në pozicionin përkatës 1 deri në 1.5 centimetra.
21 Pjesën tjetër nuk po e lexoj.

22 Dua që t'ju tregoj një fotografi tani për të konfirmuar
23 se ajo fotografi përputhet me këtë konstatim.

24 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Dhe tani të kalojmë në faqen me
25 numrin 139 të këtij dokumenti.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 22

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
2 mundet.

3 Dhe, z. Gasior, ju falënderojmë që na e shpjeguat
4 dallimin midis asaj që ju mbani mend dhe asaj që çfarë është e
5 përfshirë në raport.

6 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

7 PY. Dr. Gasior, tani që shihni fotografinë që keni përpara,
8 kjo fotografi a ilustron lëndimin në lëkurë që ndodhet në
9 paratalin e majtë në kufi të ballit, pra, në skaj të ballit,
10 të cilin sapo e cekëm?

11 PË. Nga përshkrimi, besoj se ky lëndim në të vërtetë
12 ilustrohet nga kjo pamje të cilën sapo ma treguat.

13 PY. Ju lutem, a mund të na e tregoni vendndodhjen e kësaj
14 vraje, pra, pozicionin e kësaj vraje apo shenje në modelin
15 plastik të kafkës që keni përpara?

16 PË. Është pak a shumë këtu. Pak a shumë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
18 kemi fotografinë përpara dhe besoj se e thotë qartë.

19 Shoh edhe nga avokatët e Mbrojtjes që edhe ata e kanë të
20 qartë, s'kanë kundërshtim. Në rregull.

21 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

22 PY. Çfarë do të thotë fakti se kjo shenjë nuk është e
23 bashkëngjitur në eshtrën e kafkës? E kam fjalën për mënyrën
24 sesi është përshkruar ky lëndim në faqen 137.

25 PË. Nga përshkrimi mund të arrijmë në përfundimin se vraja,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 23

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 shenja, pra, nuk është fikse, nuk është e fiksuar, lëviz do të
2 thotë që nuk është e ngjitur pas eshtrës së kafkës.

3 PY. Dhe çfarë do të thotë, pra, fakti se kjo shenjë plage nuk
4 është e fiksuar pas eshtrës së kafkës?

5 PË. Do të thotë që nuk është dëmtuar eshtra me shumë gjasë.

6 Nuk ka qenë e dëmtuar.

7 PY. Faleminderit. Ky lëndim i kokës a përputhet me supozimin
8 se individin B e kanë goditur në kokë?

9 PË. Shenja është rezultat plage. Dhe plaga mund të jetë
10 shkaktuar nga ndonjë farë traume. Përputhet me supozimin se ky
11 individ, individi B, ka pasuar traumë apo lëndim për shkak të
12 ndonjë sendi, pra, mund të jetë përdorur ndonjë send.

13 PY. Dëshiroj të kaloj tani në një fotografi tjetër të
14 raportit, por fillimisht dëshiroj që të shohim njëherë
15 konstatimet e përfshira në raport që janë në faqen me numër
16 138. Është pika e parë e listës që është në këtë faqe. Ku
17 shohim se bëhet fjalë për një lëndim të lëkurës në pjesën e
18 sipërme të supit me përmasa 2 herë 1.5 centimetra.

19 Tani dëshiroj që të kaloj një tjetër fotografi që është
20 në faqen 140 të të njëjtit raport.

21 Dr. Gasior, fotografitë që ju i keni përpara a ilustrojnë
22 këtë lëndim?

23 PË. Këto fotografi ilustrojnë lëndimet e përshkruara.

24 PY. Ky lëndim a do të përputhej me një plagë të shkaktuar nga
25 një send i mprehtë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 24

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 PË. Në këtë vend, ne shohim një vrazjë, pra, një shenjë plage.

2 Përmasat i kemi. Është rezultat i një lëndimi të kësaj pjese.

3 PY. Atëherë ta marrë, ta kuptoj prej konstatimeve tuaja se

4 nuk është e mundur të arrihet në përfundimin se nga ç'lloj

5 sendi është shkaktuar kjo?

6 PË. Tani nëse duam të flasim për sendin që ka shkaktuar këtë

7 shenjë si pasojë e një lëndimi dhe siç del edhe nga fjalët e

8 pacientit [REDAKTUAR], është një gjë tejet e

9 vështirë që ta bësh një gjë të tillë.

10 PY. Faleminderit.

11 Do të kalojmë tani tek një tjetër konstatim. Do të

12 kalojmë sërish tek faqja 138 e raportit. Është pika e dytë e

13 listës nisur nga sipër. Këtu lexoj se përmendet lëndime në

14 pjesën e poshtme të këmbës, shenjë plage me përmasë 2.5 me 0.5

15 centimetra.

16 Dr. Gasior, fillimisht shoh se është bërë një korigjim

17 në këtë faqe, pra, është fshirë fjala kafkë, eshtra e kafkës.

18 PY. A mund të na e shpjegoni përse është bërë ky korigjim?

19 PË. Ky lëndim ndodhet në këmbën e majtë, pjesën e poshtme të

20 këmbës. Është një shenjë e cila nuk ishte e lidhur pas kockës.

21 Po sigurisht pas kockës së gjymtyrës.

22 PY. Ka kaluar shumë kohë, po nuk e di nëse ju kujtohet se kur

23 e keni bërë këtë korigjim, që ta kuptojmë dhe ne këtu?

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë private)

Faqe 25

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 [REDAKTUAR]

2 PY. Faleminderit shumë.

3 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Tani ju lutem të shohim një

4 tjetër fotografi në ekran dhe është tashmë --

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund

6 të vazhdoni.

7 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po në faqen që mbaron me numrin

8 141.

9 PY. Këto fotografi a ilustrojnë lëndimin për të cilin ju sapo
10 folët?

11 PË. Kjo fotografi tregon praninë e një shenje plaje në anën e
12 majtë, në pjesën e poshtme më saktë të këmbës së majtë.

13 PY. Faleminderit.

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, me lejen

15 tuaj, pjesën në vijim ta diskutojmë në seancë private se

16 informacioni mund të identifikojë personin që është objekt i
17 këtij dokumenti.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

19 kuptoj, znj. Prokurore.

20 Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë private)

Faqe 26

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë private)

Faqe 27

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë private)

Faqe 28

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit.

16 Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

17 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

18 PY. Z. Gasior, po shkojmë në përfundim të pyetjeve tona dhe

19 do të doja të diskutonim dhe raportin tuaj të fundit. Për këtë

20 do të doja që të nxirrnim në ekran dokumentin në mënyrë që

21 dëshmitari të identifikojë fillimisht raportin. Me numër ERN

22 SITF00019793 deri në 19810. Ky raport nuk duhet transmetuar

23 për publikun.

24 A mund ta afrojmë pak, ta zmadhojmë?

25 A mund të kalojmë edhe njëherë shkurtimisht në seancë për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë private)

Faqe 29

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 të diskutuar private për të diskutuar informacione të
2 mbrojtura?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Sekretare, të lutem të kalojmë në seancë private.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21 [Seancë e hapur]

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 30

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

2 PY. Dr. Gasior, ju e keni përgatitur këtë raport?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dr.

4 Gasior, mos përmendni asgjë konkrete për raportin thjesht

5 thoni po ose jo?

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, unë. Unë e kam përgatitur këtë
7 raport.

8 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] A mund të nxjerrim faqen 3 të
9 raportit, për qëllime identifikimi. Të shkojmë pak më poshtë.

10 PY. A e njihni nënshkrimin në këtë faqe?

11 PË. Po, e njoh nënshkrimin në këtë faqe.

12 PY. I kujt është?

13 PË. Është i imi.

14 PY. Ju e keni bërë këqyrjen që diskutohet në këtë raport?

15 PË. Nga raporti del, kuptohet që e kam bërë unë,
16 personalisht, këqyrjen.

17 PY. Do të doja të shkonim në faqen 2 të raportit.

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Dhe do bëjmë të njëjtën gjë që
19 bëmë pak më herët.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
21 rregull. Vazhdoni.

22 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të shkojmë në pikën e fundit. Ju
23 kërkoj ndjesë. Pak më lart, "Informacioni i marrë nga
24 pacienti". Tek pjesa ku thuhet "Informacioni i marrë nga
25 pacienti".

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 31

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 PY. Këtu lexoj që pacienti u ka thënë ndër të tjera:

2 "Më rrahën me shkopinj dhe me duar. Më rrahën në këmbë,
3 në shputa dhe në gjithë trupin. Më dogjën me cigare në
4 kraharor, në trup në kraharor. Më rrahën me revolver në kokë
5 dhe më goditën me shkelma".

6 E kuptoj që ka kaluar shumë kohë dhe mbase nuk ju
7 kujtohet t'i keni marrë këto informacione. Prandaj fillimisht
8 unë do t'ju pyes: A konfirmoni nëse informacioni që është i
9 përmbledhur këtu është informacion që e keni marrë nga
10 pacienti?

11 PË. Informacioni në raport është informacioni të cilin e ka
12 dhënë pacienti para se të bëhet këqyrja. Është përkthyer nga
13 infermieret e mjekësisë ligjore dhe këtë informacion unë e kam
14 përfshirë në raport.

15 PY. Faleminderit. Në qoftë se duhet të shkojmë në fund të
16 faqes dhe është një pikë aty, këtu thuhet prova të lëndimeve
17 të mëhershme. Konstatohen në person dhe dua të flasë për një
18 vrajë në lëkurën në pjesën e majtë të ballit.

19 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] A mund të shohim dhe fotografinë
20 që është në faqen që përfundon me 797?

21 PY. Dr. Gasior, këto fotografi a përfaqësojnë lëndimin në
22 ballë?

23 PË. Këto fotografi, po, përfaqësojnë përshkrimin që shohim në
24 raport.

25 PY. Madhësia e vrazës, besoj se e keni përmendur dhe e keni

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 32

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 matur është në raport, ishte 4.5 centimetra në raport. A mund
2 të thoni, a mund të dilni në përfundime sa i takon natyrës së
3 këtij lëndimi sa i rëndë ishte ky lëndim?

4 PË. Vraja është pasojë e një plage që ishte shëruar. Plaga
5 ishte si pasojë e një lëndimi të shkaktuar.

6 PY. Ky lëndim a përputhet me supozimin se individi C ishte
7 rrahur në kokë me revolver?

8 PË. Është e qartë se vraja është si pasojë e një lëndimi të
9 rëndë dhe kjo është bërë me një send të rëndë, nga një send i
10 rëndë dhe me forcë.

11 PY. Faleminderit. Tani do të shkoja të flisnim po ashtu për
12 përfundimet që janë në faqen 3 të raportit.

13 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Shkojmë pak më lart. Dy pikat
14 lart në pjesën e sipërme të faqes ku flitet për vraja të
15 parregullta të shpërndara në pjesën e lartë në të djathtë të
16 kraharorit edhe në pjesën e lartë të shpallës, në pjesën e
17 sipërme të shpatullës.

18 Dhe për këtë do doja që të shihnim po ashtu fotografinë
19 në faqen që mbaron me numrin 798. Gjithashtu mund të shohim
20 edhe faqen tjetër që mbaron me numrin 799 edhe 802, faqen 802
21 pra.

22 PY. Dr. Gasior, këto fotografi a u përkojnë lëndimeve që sapo
23 përshkruat, që keni përshkruar në raportin tuaj?

24 PË. Fotografitë përfaqësojnë përshkrimet në raport.

25 PY. Këto lëndime a përputhen me supozimin se personi C është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 33

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 djegur me cigare?

2 PË. Nuk mund të përjashtohet. Vrajat janë pasojë e lëndimeve
3 që janë shkaktuar. Janë të parregullta. Kanë një formë të
4 parregullt. Janë sipërfaqësore. Mund të jenë shkaktuar si
5 pasojë e kontaktit me diçka të nxehtë me temperaturë të lartë.

6 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Shohim edhe një herë faqen 3.

7 Pikën e tretë nga lart poshtë. Këtu shohim një lëndim në
8 bërrylin e majtë që ishte pak i deformuar. Shoh që thuhet që
9 nuk e drejtonte, domethënë, nuk e drejtonte tamam bërrylin e
10 majtë e kufizuar deri në 10 për qind lëvizja dhe drejtimi i
11 bërrylit të majtë.

12 Dhe për këtë, do të doja që të shihnim fotografinë me
13 numrin 800.

14 PY. Fotografitë këtu a përfaqësojnë lëndimin në bërryl?

15 PË. Fotografitë përfaqësojnë lëndimin që ka përshkruar
16 pacienti. Mund të jetë shkaktuar një lëndim i tillë.

17 PY. Ky lëndim a përputhet me dëshminë e dhënë sa i takon
18 rrahjes që i është bërë në atë pjesë të trupit?

19 PË. Pacienti tha se i është shkaktuar lëndim. Për të
20 konfirmuar lëndimet, traumat, në strukturën kockore u udhëzua
21 që t'i bëheshin fotografi, pra, të merrej imazh fotografi të
22 bërrylit të majtë dhe kryesisht të kokës. Pjesët e trupit për
23 të cilat bëhej fjalë. Nuk ka ndonjë informacion këtu që të
24 konfirmojë se i ka ndjekur udhëzimet tona. Pra, fotografitë
25 nuk e dimë a janë bërë apo jo këto fotografi.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 34

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 PY. Besoj se e keni fjalën për fundin e faqes 795 të
2 raportit, ku ju i keni rekomanduar personit C të bëjë
3 radiografi të kokës dhe të bërrylit të majtë. Nëse e kam
4 kuptuar siç duhet. Dhe ju thoni, nuk e dimë a i ka bërë
5 radiografitë, sepse nuk i kemi pjesë të raportit, kështu?

6 PË. Nuk kam informacion që të konfirmojë se u bë radiografia
7 dhe prandaj nuk ka informacion në raport, se as unë s'kam
8 informacion nëse është bërë imazh radiografik.

9 PY. E qartë.

10 Shohim dhe përfundimin dhe fundin në këtë raport që është
11 po ashtu në faqen 3. Janë dy pikat e fundit. Këtu shohim
12 lëndimin në pjesën e tenarit që matet 2 deri në 2.5 centimetra
13 dhe pastaj në pjesën llanore laterale të kyçit të majtë.

14 Dr. Gasior, a mund ta sqaroni që ta kuptojmë çfarë është
15 tenari dhe nga dallon nga kyçi, mbase mund të na e shpjegoni
16 tek modeli që keni me vete, tek skeleti.

17 PË. [Nuk ka përkthim]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
19 po marrim përkthim.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Tenari është grupim muskujsh në
21 fund të gishtit të madh të dorës. Kjo quhet tenar.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit.

24 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Shohim fotografinë në faqen 801.

25 PY. Fotografitë a përfaqësojnë lëndimin që sapo përshkruat?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 35

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 PË. Fotografitë tregojnë lëndimin të përshkruar në raport.

2 PY. Faleminderit. Ky lëndim a përputhet me plagën të

3 shkaktuar nga një send i mprehtë?

4 PË. Vraja që shohim në fotografi është lineare. Kjo lloj

5 vraje është pasojë -- këto lloj vrazash janë pasojë e një

6 lëndimi që është shëruar, një plage që është shëruar dhe që

7 është shkaktuar me send të mprehtë.

8 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më lejoni

9 të konsultohem një çast me kolegët.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Vazhdoni.

12 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

13 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Nuk kemi më pyetje për

14 dëshmitarin dhe kaq mbyllim pyetjet tona.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Faleminderit.

17 Përfunduar me pyetjet nga Zyra e Prokurorit të

18 Specializuar, z. Gasior, tani po i drejtohem Mbrojtësit të

19 Viktimave në qoftë se ka ndonjë pyetje.

20 Mbrojtësi i Viktimave, a keni pyetje?

21 Z. LAWS: [Përkthim] Po, unë kam. Po do më duhet më shumë

22 kohë seç thashë dje. Do më duhen rreth 20, 25 minuta.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

24 rregull.

25 Atëherë ne do të bëjmë pushimin deri në orën 11.30 dhe do

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 36

Pyetje nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 të vazhdojmë me pyetjet nga Mbrojtësi i Viktimave pas
2 pushimit.

3 Z. Gasior, tani do të bëjmë pushimin. Asistentja do t'ju
4 shoqërojë jashtë sallës së gjyqit dhe do të shihemi sërish në
5 orën 11.30. Faleminderit.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Seanca ndërpritet deri në orën 11.30.

9 --- Pauza fillon në orën 10.57

10 --- Seanca rifillon në orën 11.31

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
12 se erdhët.

13 Shoh që ZPS-ja është me të njëjtën përbërje. E njëjta gjë
14 është edhe për Mbrojtjen e Viktimave dhe e njëjta gjë edhe për
15 ekipin e Mbrojtjes.

16 Z. Shala, është po ashtu i pranishëm. Më dëgjon z. Shala?

17 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj shumë
18 mirë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
20 faleminderit.

21 Atëherë do të vazhdojmë me pyetjet e dëshmitarit nga
22 Mbrojtësi i Viktimave. Do i kërkoj znj. Sekretare që ta sjellë
23 dëshmitarin në sallë dhe më pas do t'i jap fjalën Mbrojtësit
24 të Viktimave.

25 Na thatë z. Mbrojtës i Viktimave që do ju duhen pak a

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 37

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 shumë 20 minuta, kështu?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Merrni gjithë kohën që ju nevojitet.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Mbase mund të jetë pak më pak sesa

6 ajo çfarë thashë më herët.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

9 se erdhe, Dëshmitar. Uluni, ju lutem.

10 Edhe njëherë mirë se erdhët. Ju lutem zini vend, uluni.

11 Z. Gasior, tani do të vazhdojmë nga pyetjet nga Mbrojtësi
12 i Viktimave, do t'i jap tani fjalën atij.

13 E keni fjalën ju, z. Laws.

14 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

15 Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave:

16 Z. LAWS: [Përkthim]

17 PY. Mirëmëngjes, z. Gasior. Unë jam Simon Laws. Jam Mbrojtësi
18 i Viktimave në këtë çështje.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

20 Gasior, e morët përkthimin? E dëgjuat z. Laws?

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, po, e dëgjoj përkthimin.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

23 rregull. Z. Laws, përpara sesa të vijoni me pyetjet dhe

24 përgjigjet, dua që t'i kërkoj dhe njëherë z. Shala të na thotë

25 në qoftë se ai dëgjon përkthimin.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 38

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 E dëgjuar përgjigjen, z. Shala?

2 Z. LAWS: [Përkthim]

3 PY. Nëse e kuptove drejt dje, ju na thatë që kishit më tepër

4 sesa katër vjet që bënit autopsi të trupave të gjetura në

5 Kosovë, kështu na thatë dje?

6 PË. Në Kosovë kam punuar gjatë kohës nga viti 2000 deri në

7 2012, domethënë, kam punuar 12 vjet gjithsej.

8 PY. Atëherë keni punuar gjithsej 12 vjet, domethënë, jo vetëm

9 nga viti 2008 deri në vitin 2012, por nga viti 2000 deri në

10 vitin 2012.

11 PË. Po, po kam bërë një vit shkëputje. Sepse kam qenë një vit

12 në Bosnjë. Atëherë unë e kam filluar punën në vitin 2000 dhe

13 pastaj e kam zgjatur atë deri në vitin 2012, ka zgjatur nga

14 viti 2000 deri në 2012.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani

16 më lejoni që të pyes z. Shala në qoftë se dëgjoni përkthimin.

17 E dëgjoni përkthimin, e dëgjuat përgjigjen e ekspertit sa

18 për të qenë të sigurtë që na dëgjoni mirë, z. Shala?

19 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e ndëgjoj shumë

20 mirë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

22 faleminderit, z. Shala.

23 Mund të vazhdoni, Mbrojtësi i Viktimave.

24 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit

25 PY. Kur u mor vendimi për të zhvarrosur një trup, juve a

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 39

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 ishiti i njohur me rolin e gjykatësit sa i takon mënyrës sesi
2 duhet të ndodhte ose si duhet të realizohej zhvarrimi?

3 PË. Unë merrem në punë nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore
4 dhe kam kryer autopsi në kuadër të atij departamenti.
5 Autopsitë urdhëroheshin nga shefat e mi.

6 PY. Ju kërkoj ndjesë se ju ndërpreva kam përshtypjen. Nuk e
7 di në qoftë se doni të shtoni diçka tjetër. Ju kërkoj ndjesë
8 që ju preva se po thoni diçka, jua preva fjalën në mes. Pra, e
9 përfunduat atë çfarë po thoni? E përfunduat përgjigjen?

10 PË. Po, po e përfundova.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Prisni që t'ju jap fjalën për të folur dhe pastaj flisni.

13 Tani e keni fjalën.

14 Z. AOUBINI: [Përkthim] U korrigjua. U korrigjua. Kisha për
15 të thënë diçka lidhur me korrigjimin në transkript, megjithatë
16 u korrigjua.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit. Faleminderit edhe që e ndiqni transkriptin.

19 Z. LAWS: [Përkthim]

20 PY. Pra, parimet janë ato që ju drejtojnë juve ose ju
21 udhëzojnë juve për të kryer autopsinë, kështu, domethënë,
22 autopsinë e kryeni mbi bazën e parimeve udhëzuese, kështu?

23 PË. Unë isha mjek dhe isha i punësuar nga Departamenti i
24 Mjekësisë Ligjore, unë mora informacion që më duhej që të
25 kryeja një autopsi. Domethënë, kjo ka qenë ajo çfarë ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 40

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 ndodhur.

2 PY. Në rregull. Thjesht doja të dija nëse e njihni se çfarë
3 roli kryen gjykatësi për sa i takon urdhrit të zhvarrosjes së
4 një kufome të vdekur nga dheu në mënyrë të tillë që të kryhet
5 një autopsi. Domethënë, thjesht doja të dija, dua t'ju pyes në
6 qoftë se a e dini që kjo është ajo çfarë ndodh. Pra, duhet që
7 gjykatësi të japë një urdhër që të kryhet autopsia?

8 PË. Unë kam marrë informacion të përgjithshëm lidhur me
9 procedurat. E dija që zhvarrimi ishte kryer në pajtim me
10 urdhrat e autoritete ose organeve përgjegjëse, sikurse e
11 shpjegova dhe dje, trupat e zhvarrosur u transportuan në
12 Departamentin e Mjekësisë Ligjore dhe më pas ekipi dhe unë
13 bashkë me ta, kryem autopsitë përkatëse.

14 Z. LAWS: [Përkthim] Doktor, në qoftë se na lejon Trupi
15 Gjykues, nuk e di në qoftë se mund të shohim një pjesë tjetër
16 të dokumentit që e këqyrëm dhe dje që është dokumenti, pra, do
17 të vazhdojmë me këtë temë pra, me pjesën e mëparshme të
18 hetimeve që ka çuar më pas në zhvarrosjen. Dhe kjo përfshihet
19 si pjesë e dokumentacionit në raportin që jepet me numër
20 identifikimi 031049-031095 RED2.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Vazhdoni, znj. Sekretare, paraqiteni në ekran.

23 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit

24 PY. Doktor, a ju kujtohet që e pamë këtë dokument edhe dje,
25 pra, ky është raporti që pamë dhe dje është raporti që e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 41

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 shikoni në ekran dhe a e kujtoni që e pamë këtë raport edhe
2 disa faqe të tjera më poshtë këtij raporti. Ju kujtohet kjo?
3 PË. Po, më kujtohet.

4 PY. Në qoftë se shkojmë në fund fare të dokumentit. Do i
5 kërkoja Sekretares të kalojmë deri në fund në faqen e fundit
6 të dokumentit, në faqen 47, kemi një dokument që përfshihet në
7 këtë grupin e madh të dokumenteve që është urdhri për
8 zhvarrosjen, pra, është urdhri i gjykatësit të EULEX-it që
9 mban datën [REDAKTUAR] A e shikon këtë dokument,
10 doktor?

11 PË. Po, po e shoh atë dokument.

12 PY. Nuk është e nevojshme që ta lexojmë. Por është një urdhër
13 i gjykatësit që urdhëron zhvarrosjen që ka të bëjë me personin
14 A. Por, gjithsesi domethënë, e thamë dhe më përpara që ky
15 është një dokument i datës [REDAKTUAR] A mund ta
16 shohim pak më sipër dokumentin, mund të kalojmë dy faqe
17 përpara këtij dokumenti.

18 Doktor, ky është një dokument i cili është hartuar dhe
19 është pjesë e të gjitha dokumenteve të tjera, është akti i
20 zhvarrosjes, është raporti i zhvarrosjes dhe mban datën
21 [REDAKTUAR] A e sheh këtë dokument në ekran, doktor?

22 PË. Po, e shoh dokumentin.

23 PY. Ajo që dëshiroj t'ju pyes është si më poshtë: Kanë kaluar
24 dy javë nga momenti që është nxjerrë urdhri i gjykatësit deri
25 tek raporti, [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 42

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 [REDAKTUAR] A më ndjek deri tani? Po?

2 PË. Po, po, ju ndjek.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Kjo nuk është për transmetim për
4 publikun, besoj që është e qartë kjo.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
6 asgjë nuk transmetohet për publikun.

7 Z. LAWS: [Përkthim]

8 PY. A jeni ju në dijeni, doktor, nëse ka qenë praktikë e
9 përgjithshme që të jepej një njoftimi mëparshëm ndokujt sa i
10 takon synimit për të kryer një zhvarrosje, a bëhej njoftim
11 paraprak, domethënë, përpara sesa të kryhej zhvarrosja në
12 përgjithësi?

13 PË. Besoj që kjo është një pyetje që i duhet drejtuar shefit
14 të atëhershëm të Departamentit të Mjekësisë Ligjore. Ai ishte
15 personi përgjegjës për të gjitha procedurat administrative të
16 institucionit.

17 PY. E kuptoj në qoftë se nuk i jepni përgjigje ose nuk na
18 ndihmoni dot në lidhje me këtë. Por thjesht doja t'ju pyesja
19 në qoftë se keni ndonjë informacioni lidhur me këtë pyetje,
20 diçka që mbase e keni mësuar nga kolegët tuaj ndër vite.

21 PË. Në praktikë ekipi, domethënë, ekipi përgjegjës për
22 zhvarrosjen në Departamentin e Mjekësisë Ligjore në OMPF ka
23 shkuar së bashku me oficerët e policisë dhe me arkeologët në
24 mënyrë që të mund të kryhet zhvarrosja. Sikurse e thashë dhe
25 dje, trupat janë transportuar pastaj në Departamentin e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 43

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 Mjekësisë Ligjore.

2 Megjithatë, sa më takon mua, unë për vete kam qenë
3 përgjegjës vetëm për kryerjen e autopsisë dhe për dhënien e
4 shkakut të vdekjes, pra, për të specifikuar se kush ishte
5 shkak i vdekjes.

6 Z. LAWS: [Përkthim] Ndërkohë që e kemi të shfaqur në
7 ekran këtë dokument, nuk e di në qoftë se mund të kalojmë më
8 poshtë, në faqen tjetër të dokumentit. Nuk do ta lexoj me zë
9 sepse mund të jetë informacion identifikues.

10 PY. Mund të shohim tek pjesa e shënimit në fund të faqes që
11 thuhet që nuk kishte njoftim paraprak. Pra, ju po thoni që nuk
12 e di në qoftë se kjo ka qenë praktikë e zakonshme apo jo,
13 kështu?

14 PË. Çfarë doni të thoni, nuk e kuptoj?

15 PY. Sa i takon zhvarrosjes së trupit për të cilin ju kryet
16 autopsinë, mund të shihni në ekran aty ngjitur me fjalën
17 shënim, "Note" në anglisht, që të paktën një individ nuk ishte
18 i informuar për këtë proces zhvarrimi.

19 Pra, juve thatë që nuk e keni idenë në qoftë se kjo ishte
20 praktikë e zakonshme apo jo, kështu apo?

21 PË. Nuk kam njohuri për këtë, nuk kam dijeni për këtë. Unë në
22 kuadër të detyrave të mia nuk merrja pjesë në zhvarrimet në
23 terren.

24 Z. LAWS: [Përkthim] A mund të kalojmë tek faqja tjetër e
25 dokumentit që kemi përpara në ekran? Le të shohim fundin e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 44

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 faqes, këto fotot që janë në fund.

2 PY. Kjo në fund fare, në të majtë, a është ky thesi ose qesja
3 plastike që keni marrë, pra, a është ky thesi që keni marrë
4 për të bërë autopsinë juve?

5 Nëse ju ndihmon, mund të shikoni një numër që keni aty
6 sipër. Është numri që i është dhënë hetuesve në këtë rast. Në
7 qoftë se mund ta zmadhoj Sekretarja për ta parë numrin më
8 mirë. Besoj që mund ta shikoni dhe ju numrin, pra, është numri
9 [REDAKTUAR] Ky është numri i hetimit.

10 PË. Më vjen keq nuk mund t'i jap një përgjigje kësaj
11 pyetjeje. Unë personalisht nuk kam qenë i përfshirë në
12 procesin e zhvarrimit. Nuk kam qenë në teren. Si rregull nuk
13 shkoj asnjëherë në terren.

14 Megjithatë, unë kam qenë përgjegjës për të bërë autopsinë
15 e pacientëve trupat e të cilëve janë dërguar apo janë sjellë
16 në Departamentin e Mjekësisë Ligjore.

17 PY. Në rregull është. Shumë mirë. Shumë faleminderit.

18 Z. LAWS: [Përkthim] Këto janë pyetjet që kam për mjekun,
19 për doktorin.

20 Mbase ta zvogëlojmë pak fotografinë këtu edhe ta shikojmë
21 pak më sipër në qoftë se është e mundur. Në mënyrë të tillë që
22 të shikojmë këto fotografitë në fillim fare të faqes. Shumë
23 mirë kështu. Këtu është shumë mirë.

24 Thjesht një shënim për procesverbal. Ky është varri, pra,
25 në fillim fare në të djathtë dhe varri në mes është varri i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 45

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 personit A përpara sesa të bëhej zhvarrimi. Ndërkohë që
2 personi, domethënë, më poshtë jepet fotografia e personit pas
3 zhvarrimit.

4 PY. Faleminderit, mjek.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Avokati i Viktimave këto ishin pyetjet tuaja apo jo?

7 Z. LAWS: [Përkthim] Këto ishin pyetjet e mia.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit.

10 Avokati i Mbrojtjes, e keni ju fjalën.

11 Z. AOUBINI: [Përkthim] Ndoshta do ishte mirë që të

12 redaktojmë numrin e çështjes nga transkripti.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] U bë.

14 E kemi redaktuar tashmë.

15 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

17 mirë.

18 Z. Gasior, për sot kemi përfunduar me dëshminë tuaj
19 përpara Trupit Gjykes. Dje dhe sot ju mori në pyetje Zyra e
20 Prokurorit të Specializuar, ju mori gjithashtu, sot në pyetje
21 Avokati i Viktimave. Do të vazhdojmë me kundërpvetjet nga
22 ekipi i Mbrojtjes i z. Shala javës që vjen, të hënën e javës
23 që vjen. Më informuan që juve ju kanë treguar lidhur me këtë.

24 Ju falënderoj shumë për kohën sot. Dhe më lejoni t'ju
25 kujtoj z. Gasior që nuk duhet ta diskutoni dëshminë tuaj me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 46

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 askënd në ditët në vijim. A është e qartë kjo?

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, është e qartë dhe është e
3 vetëkuptimtë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
5 duhet ta them gjatë gjithë kohës këtë gjë dhe më duhet t'i
6 kujtoj të gjithë dëshmitarëve për faktin që kur janë në betim
7 nuk duhet të bisedojmë për çështjen me asnjë palë tjetër.

8 Përsëris, Sekretarja do të nxjerrë nga salla e gjyqit. Do
9 të takohemi përsëri bashkë në orën 9.30 ditën e hënë të javës
10 që vjen.

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit, Sekretare.

14 A ka ndonjë gjë tjetër që palët dhe Mbrojtësi i Viktimave
15 dëshirojnë që të ngrenë me Trupin Gjykses? Jo?

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për
17 momentin ZPS-ja do presë për deri javën tjetër për vendimin
18 përfundimtar sa i takon le të them mënyrës sesi do të
19 procedojmë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
21 Do të vazhdojmë, pra, do propozoja që të bënit lidhjen me
22 Zyrën e Administrimit Gjyqësor të cilët do bëjnë, le të themi,
23 pjesën e ndërlihdjes dhe pjesën sesi do të bëhet organizimi
24 për javën tjetër.

25 Mbrojtësi i Viktimave, keni ndonjë pyetje?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 47

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F557RED dhe F631.

1 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Mbrojtja e të akuzuarit keni ndonjë pyetje?

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Atëherë, më lejoni të falënderojë palët. Faleminderit ZPS-së.

7 Faleminderit Mbrojtësit të Viktimave, Mbrojtësit të të

8 akuzuarit. Faleminderit përkthyesit, nga personat teknikë,

9 gjithashtu edhe faleminderit departamentit të sigurisë për

10 ndihmën e tyre.

11 Seanca mbyllet këtu deri të hënën në orën 9.30 të

12 mëngjesit.

13 --- Seanca mbyllet në orën 11.53

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25